



11/07/2023

Tiranë – Vihen Në Pranga 8 Shtetas

Tiranë

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve arrestuan shtetasit A. Gj., 30 vjeç, banues në Tiranë, dhe F. Q., 29 vjeç, banues në Lushnjë, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Policisë iu gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, sasi të vogla të lëndëve të dyshuara narkotike kanabis dhe kokainë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 arrestuan shtetasin R. P. (L.), 30 vjeç, banues në Surrel, pasi ka ndërtuar një objekt, në tejkalim të lejes së dhënë nga organet kompetente.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 6 arrestuan shtetasit P. T., 31 vjeç, banues në Pezë Helmës, dhe D. H., 45 vjeç, banues në Librazhd. Shërbimet e Policisë kanë ndaluar për kontroll automjetin me drejtues shtetasin P. T. dhe pasagjer shtetasin D. H., të cilët sapo kanë parë shërbimet e Policisë, kanë hedhur nga automjeti, një send të dyshuar silenciator dhe 3 fishekë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Krujë arrestuan një shtetas të mitur 17 vjeç, pasi është kapur duke drejtuar një automjet, pa leje drejtimi, dhe gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Policisë i gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një dorezë hekuri (përforcues grushti).

Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasit:

- G. K., 18 vjeç, banues në Tiranë, pasi u kap duke drejtuar motomjetin, pa leje drejtimi;
- E. S., 26 vjeç, banues në Tiranë, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Tiranë/Informacion paraprak

Më datë 11.07.2023, në Rugën e Qelqit, në Kombinat, në banesë është gjetur nga bashkëshorti i saj, pa shenja jete shtetasja Dh. J., 33 vjeçe.

Nga këqyrja paraprake nuk janë konstatuar shenja dhune dhe vdekja dyshohet se ka ardhur nga shkaqe natyrale.

Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)